



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2265/ 3 prot.,

Datë 19.09.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*Leon Konstruksion*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-77189–08–10-2023, me objekt “*Rehabilitimi i ambienteve tek kompleksi “Fushat sportive Pishinat”*” me fond limit: 28,023,943 (njëzetë e tetë milion e njëzetë e tre mijë e nëntëqind e dyzetë e tre) Lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 28.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Qendra Sportive Tirana.
- Ankimues:** Operatori ekonomikë “*Leon Konstruksion*” SHPK me NIPT K71820009I, me adresa: rruga “*Tish Dahia*”, Kika 2, Godinë 9, Kati 8, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Qendra Sportive Tirana.
Adresa: Rruga “*Kristo Luarasi*”, Tiranë.

Në datën 18.09.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. 2265 protokoll, datë 18.09.2023 e operatorit ekonomik “*Leon Konstruksion*” SHPK për procedurën e “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-77189–08–10-2023, me objekt “*Rehabilitimi i ambienteve tek kompleksi “Fushat sportive Pishinat”*” me fond limit: 28,023,943 (njëzetë e tetë milion e njëzetë e tre mijë e nëntëqind e dyzetë e tre) Lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 28.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Qendra Sportive Tirana.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Leon Konstruksion” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “Leon Konstruksion” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 2265 prot., datë 18.09.2023.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

- **Arsyet e skualifikimit:**

Oferta e paraqitur nga operatori Leon Konstruksion sh.p.k. skualifikohet, pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plote dhe te sakte per te deshmuar plotesimin e te gjitha kriterëve te kerkuara ne DST, konkretisht nuk ka plotesuar kriteret sipas:

2.3.3 Dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik:

O.E. nuk ka paraqitur vertetimin e kontributeve, listepagesat per periudhen Maj -Korrik 2023, gjithashtu nuk ka paraqitur dhe dokumentacionin shoqerues per drejtuesit Teknik te kerkuar , ku perfshihen “ Kontratë pune, Diplomën Universitare, Libreze pune dhe Cv”.

O.E. gjithashtu nuk ka paraqitur dhe dokumentacionin shoqerues per punonjës të specializuar/të kualifikuar te kerkuar, ku perfshihen

- *kontratën individuale të punës;*

- *një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional /certifikatë/diplomë), lëshuar nga*

institucione (shtetërore apo private) të licencuara /akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”.

2.3.4 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës:

O.E. nuk ka paraqitur dokumentacionin për makineritë, të cilat janë në pronësi ose me qera, Për mjetet që janë në pronësi, duhet të paraqitet :

- a) *dokumenti që vërteton pronësinë (çertifikatën e pronësisë së mjetit rrugor);*

- b) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);*
- c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);*
- d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;*
- e) leje transporti nga njësia vendore (sipas rastit);*
- f) foto të mjetit ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.*

Kur janë me qera, duhet të paraqitet :

- a) kontrata e qerasë;*
- b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);*
- c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);*
- d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;*
- e) leje transporti nga njësia vendore (sipas rastit);*
- f) foto të mjetit ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij. Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 19.09.2023.*

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaïd Myzyri